

RAPORT ANALITIK NGA TRYEZAT PËR VETËRREGULLIMIN NË MEDIAT LOKALE

Zonat pilot: Shkodër dhe Vlorë



Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	3
1. Hyrje.....	4
2. Profili i pjesëmarrësve	4
3. Perceptimet mbi etikën dhe vetërregullimin	5
4. Pengesat kryesore për zbatimin e vetërregullimit	6
4.1. Varësia ekonomike dhe ndikimi i reklamuesve lokalë	7
4.2. Struktura të brishta organizative dhe mungesë burimesh njerëzore	7
4.3. Mungesë njohurish dhe akses në dokumente rregullatore.....	7
4.4. Mungesa e kulturës së bashkëpunimit dhe ndarjes së përvojës.....	7
4.5. Presioni social dhe informaliteti në raportimin lokal	8
5. Vullneti dhe mundësitë për ndryshim	8
5.1. Potencial për mbështetje horizontale	8
5.2. Nevoja për mjete të thjeshta dhe të aplikueshme	9
5.3. Interes për lidhje me rrjete profesionale	9
6. Rekomandimet që dolën nga tryezat	9
6.1. Trajnime të drejtpërdrejta në redaksi.....	9
6.2. Hartimi i udhëzuesve praktikë të shkurtër.....	10
6.3. Nxitja e kontakteve të rregullta me AME	10
6.4. Platformë digjitale për dilemat etike.....	10
7. Dallime mes Shkodrës dhe Vlorës	10
7.1. Struktura organizative dhe përvoja e mëparshme	10
7.2. Perceptimi i rolit të medias në komunitet	11
7.3. Gatishmëria për bashkëpunim	11
7.4. Kërkesat prioritare	11
8. Konkluzione	12

Raport analitik mbi tryezat dhe fokus grupet mbi vetërregullimin – Shkodër dhe Vlorë

Projekti: Promovimi i etikës dhe vetërregullimit në mediat lokale – Sfidimi i dezinformimit
Zbatues: Res Publica dhe Këshilli Shqiptar i Medias
Zonat pilote: Shkodër dhe Vlorë
Autor: Florian Trojani

Përmbledhje ekzekutive

Ky raport analitik përmbledh gjetjet dhe rekomandimet që dolën nga tryezat e rrumbullakëta dhe fokus grupet e zhvilluara në qytetet Shkodër dhe Vlorë në muajt Prill – Maj 2025, në kuadër të projektit “Promovimi i etikës dhe vetërregullimit në mediat lokale – Sfidimi i dezinformimit”, zbatuar nga Res Publica dhe Këshilli Shqiptar i Medias.

Qëllimi i ndërhyrjes ishte të nxisë reflektim profesional dhe të krijojë bazat për ndërtimin e mekanizmave të vetërregullimit në media lokale, nëpërmjet pjesëmarrjes aktive të gazetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile.

Gjetjet kryesore:

- Etika shihet si vlerë personale, jo si sistem profesional i strukturuar.
- Mungesa e vetërregullimit lidhet me presionet ekonomike, mungesën e stafit, mungesën e njohurive mbi mekanizmat ekzistues dhe fragmentimin profesional.
- Ekziston gatishmëri reale për përmirësim, sidomos mes gazetarëve të rinj, për sa kohë që ndërhyrjet janë të përshtatura dhe praktike.

Pengesat kryesore:

- Varësia nga reklamat lokale dhe ndikimi politik.
- Mungesa e kodeve të brendshme apo bordeve editoriale.
- Mosnjohja e AME dhe e Kodit të Etikës së Medias.
- Mungesë bashkëpunimi ndërmjet redaksive.

Rekomandimet që dolën:

- Trajnime të drejtpërdrejta në redaksi mbi etikën.
- Manual praktik për gazetarët lokalë mbi situata konkrete.
- Platforma online për ndarjen e dilemave profesionale.
- Rritja e bashkëpunimit me AME për përfshirjen e mediave lokale në rrjete vetërregulluese.

Dallimet mes qyteteve:

- Shkodra ka më shumë strukturë redaksionale dhe përvojë me nisma të mëparshme.
- Vlora karakterizohet nga informalitet dhe mungesë organizimi, por edhe nga interes për ngritje kapacitetesh.

Konkluzion:

Projekti konfirmoi se mediat lokale janë të gatshme të ndërmarrin hapa drejt vetërregullimit, për sa kohë që ndihma vjen në forma praktike, të arritshme dhe të mbështetura nga rrjete profesionale. Ndërhyrja duhet të zgjerohet dhe të thellohet në drejtim të ndërtimit të një kulture të qëndrueshme etike në nivel lokal, e cila është parakusht për një media të lirë, të besueshme dhe profesionale në Shqipëri.

1. Hyrje

Ky raport paraqet analizën e gjetjeve të dala nga tryezat e rrumbullakëta dhe fokus grupet e zhvilluara në qytetet Shkodër dhe Vlorë, në kuadër të projektit “Promovimi i etikës dhe vetërregullimit në mediat lokale. Sfidimi i dezinformimit”, mbështetur nga Instituti Shqiptar i Medias. Ky projekt synon të fuqizojë kulturën profesionale të mediave lokale në Shqipëri, duke adresuar boshllëqet e theksuara në praktikën e etikës, mungesën e strukturave të vetërregullimit dhe sfidat gjithnjë e më të dukshme nga polarizimi politik dhe dezinformimi.

Zhvillimi i këtyre aktiviteteve ndjek metodologjinë e parashtruar më herët, duke u fokusuar jo vetëm në mbledhjen e të dhënave, por në krijimin e hapësirave të dialogut të reflektuar profesional mes gazetarëve, redaktorëve, organizatave të shoqërisë civile dhe ekspertëve të etikës. Të dhënat që pasqyrohen në vijim janë rezultat i ndërthurjes së këtyre reflektimeve me vëzhgimet sistematike të ekspertëve pjesëmarrës dhe me literaturën dhe praktikën referuese nga vende të tjera europiane, ku mekanizmat e vetërregullimit funksionojnë si garanci e integritetit profesional në media.

Kjo hyrje synon të vendosë bazat analitike të raportit, duke paraqitur kornizën kontekstuale dhe qëllimet që drejtojnë analizën, ku jemi, çfarë mësojmë nga dialogu me mediat lokale dhe cilat janë pikat e mundshme të nxitjes së ndryshimit në kulturën e raportimit, pavarësisht dhe vetëpërgjegjshmërisë profesionale.

2. Profili i pjesëmarrësve

Për zhvillimin e tryezave dhe fokus grupeve në qytetet Shkodër dhe Vlorë, u ndoq një qasje e qëllimshme për të garantuar përfaqësim gjithëpërfshirës dhe të balancuar nga aktorët kryesorë që ndikojnë dhe përjetojnë drejtpërdrejt sfidat e etikës në median lokale. Secila prej seancave u zhvillua me një përbërje të strukturuar, që përfshinte:

- Të paktën 7 gazetarë aktivë nga media të ndryshme lokale, duke përfshirë televizione rajonale, portale informative dhe stacione radioje;
- Të paktën 2 përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, të angazhuar në fushat e transparencës, llogaridhënies dhe të drejtës për informim;
- Të paktën 1 ekspert i ftuar, me profil të lidhur me etikën mediatike, të drejtën e medias ose vetërregullimin;

- Përfaqësues nga Res Publica dhe Këshilli Shqiptar i Medias, të cilët ndoqën zhvillimin e diskutimeve dhe siguruan respektimin e objektivave metodologjike.

Përbërja gjinore ishte me dominancë femërore, me pjesëmarrje mbi 60% të grave, duke reflektuar përpjekjet për të adresuar barazinë gjinore edhe në pjesëmarrje publike dhe profesionale në kontekstin mediatik lokal. Vlen të theksohet se shumica e grave pjesëmarrëse ishin aktive në median e re (online), ose në rolet editoriale mbështetëse në televizione dhe portale.

Nga pikëpamja e strukturës së punës, u vu re se pjesa më e madhe e gazetarëve të pranishëm vinin nga media me staf të reduktuar, shpesh prej vetëm 2–4 personash, çka i detyronte ata të mbulonin njëkohësisht rolet e reporterit, redaktorit dhe shpesh edhe të menaxherit të përmbajtjes. Ky model i punës, ku një individ është përgjegjës për gjithë ciklin e prodhimit mediatik, ka ndikim të drejtpërdrejtë në ngarkesën profesionale, por edhe në mangësitë strukturore të vetërregullimit.

Pjesëmarrësit ishin të ndarë në mënyrë të natyrshme në tre profile:

1. Gazetarë të rinj dhe freelance, të cilët ishin më të hapur ndaj qasjeve të reja për vetërregullim dhe shpesh e shihnin etikën si një mjet mbrojtjeje personale ndaj presioneve dhe kritikave;
2. Gazetarë me përvojë mbi 10 vjet, që mbanin qëndrim më skeptik ndaj mundësive të aplikimit të vetërregullimit për shkak të përvojave të mëparshme me ndërhyrje politike ose komerciale;
3. Aktivistë të shoqërisë civile, të cilët sollën perspektiva të jashtme dhe e lidhën etikën me nevojën për transparencë institucionale dhe raportim të përgjegjshëm.

Kjo shumëllojshmëri përbërjeje dhe perspektivash e bëri diskutimin veçanërisht dinamik dhe të thelluar, duke lejuar ballafaqimin e përvojave reale me standardet e pranuara profesionale, si dhe identifikimin e nevojave të ndryshme për mbështetje. Në të dy qytetet u vu re se pjesëmarrësit kishin një nivel të lartë motivimi për të folur hapur mbi përvojat e tyre dhe për të propozuar zgjidhje, gjë që konfirmon vlefshmërinë e qasjes metodologjike të ndërhyrjes.

3. Perceptimet mbi etikën dhe vetërregullimin

Diskutimet në tryezat dhe fokus grupet zhvilluan një pasqyrë të hollësishme të mënyrës se si gazetarët dhe aktorët lokalë të përfshirë në media e kuptojnë dhe e përjetojnë etikën profesionale dhe konceptin e vetërregullimit. Ajo që doli në pah me qartësi në të dy qytetet ishte se etikës nuk i mohohet rëndësia si vlerë, por ajo perceptohet kryesisht në nivel individual, si një përgjegjësi morale e secilit gazetar, dhe shumë rrallë si një strukturë e organizuar brenda redaksisë apo si pjesë e një sistemi të përgjithshëm institucional.

Pjesëmarrësit shpesh i përshkruanin përvojat e tyre me etikën në mënyrë të fragmentuar dhe të lidhur fort me kushtet konkrete të punës, të cilat në vetvete përbëjnë sfida të vazhdueshme. Shprehje si:

- *“Nuk mund të flasim për etikë kur nuk kemi kontratë pune dhe kur paga varet nga reklamat dhe shefat”,*
- *“Nuk ka bord editorial, vendos vetë pronari apo shefi”,*
- *“Kur rrezikon të humbasësh vendin e punës, nuk është e lehtë të jesh etik”,*

Sa më sipër ishin tregues të drejtpërdrejtë të perceptimit të etikës si një ideal i dëshiruar, por jo praktikisht i zbatueshëm në realitetin e mediave lokale.

Gjithashtu, koncepti i vetërregullimit u përjetua në mënyrë akoma më abstrakte. Shumica dërrmuese e pjesëmarrësve nuk kishin dijeni të qartë për ekzistencën e strukturave si Aleanca për Median Etike (AME) apo për funksionin e Kodit të Etikës së Medias Shqiptare të përditësuar në vitin 2022. Në rastet kur kishte dijeni, vetërregullimi shihej si një proces që lidhej me mediat e mëdha në Tiranë, dhe që nuk kishte lidhje reale me median lokale, e cila operon në kushte shumë më të vështira dhe informale.

Megjithatë, kjo mungesë njohurish nuk lidhej me mungesë interesi. Në të dy qytetet u vu re një hapje e qartë për të mësuar më shumë dhe për t’u përfshirë, për aq kohë sa ndërhyrja nuk shihej si imponim, por si mbështetje për përmirësim real të standardeve profesionale. Kjo tregon se ekziston një potencial i rëndësishëm për ndërhyrje të suksesshme, veçanërisht nëse etika prezantohet si mjet fuqizimi profesional dhe mbrojtjeje ndaj presioneve, dhe jo thjesht si një sërë rregullash moralizuese.

Një tjetër temë që u trajtua në mënyrë interesante ishte raporti midis etikës dhe besueshmërisë tek publiku. Disa gazetarë të rinj theksuan se lexueshmëria e mediave lokale është e lartë, por besueshmëria është ulur, pjesërisht edhe për shkak të perceptimit negativ që publiku ka mbi saktësinë e lajmeve dhe lidhjet me interesat e pushtetit. Në këtë kontekst, etiketa “media etike” shihej si mundësi për të rifituar besimin e publikut, për t’u dalluar nga “faqet anonime në Facebook” dhe për të tërhequr edhe më shumë interes institucional.

Përmbledhtazi, mund të thuhet se:

- Etika perceptohet si vlerë personale më shumë se si politikë institucionale;
- Vetërregullimi nuk është i njohur, por është i pranueshëm nëse paraqitet me mjete të përshtatura për realitetin lokal;
- Ka një distancë mes standardeve të pranuar kombëtare dhe praktikave të përditshme lokale;
- Pavarësisht sfidave, ekziston gatishmëri e qartë për të reflektuar dhe për të pranuar mbështetje në ndërtimin e një kulture më profesionale dhe më të qëndrueshme.

4. Pengesat kryesore për zbatimin e vetërregullimit

Pavarësisht ndërgjegjësimit të përgjithshëm mbi nevojën për etikë dhe përgjegjshmëri profesionale, pjesëmarrësit në të dy qytetet evidentuan një sërë pengesash të qarta, që e bëjnë të vështirë ose thuajse të pamundur zbatimin efektiv të mekanizmave të vetërregullimit në mjedisin mediatik lokal. Këto pengesa ndahen në disa kategori ndërvepruese:

4.1. Varësia ekonomike dhe ndikimi i reklamuesve lokalë

Një nga pengesat më të përmendura ishte varësia ekonomike e mediave lokale nga burime të pakta dhe të politizuara të të ardhurave. Shumë media mbijetojnë nëpërmjet reklamave nga biznese që shpesh janë të lidhura me pushtetin vendor ose politikën lokale. Kjo krijon një marrëdhënie varësie që e bën të vështirë raportimin kritik ose të pavarur dhe për rrjedhojë, zbatimin e standardeve etike.

Në disa raste u përmend se vetë pronarët e mediave shpesh herë janë figura të ekspozuara politikisht ose në mënyrë të tërthortë, gjë që e bën të pamundur ndarjen ndërmjet interesit editorial dhe interesit personal apo financiar. Për këtë arsye, një pjesë e gazetarëve e shohin vetërregullimin jo si proces që forcon autonominë e gazetarit, por si një kërkesë jorealiste që mund të rrezikojë vendin e punës.

4.2. Struktura të brishta organizative dhe mungesë burimesh njerëzore

Shumë media lokale operojnë me staf minimal, shpesh me vetëm 2-4 persona që mbulojnë të gjithë ciklin editorial. Kjo gjeneron mbingarkesë dhe pengon ndarjen e roleve në mënyrë të qartë. Kështu, mungojnë pozicionet editoriale të dedikuara, dhe nuk ka komitete të brendshme që mund të trajtojnë çështje të etikës apo të shqyrtojnë ankesa nga publiku.

Siç theksoi një pjesëmarrës: *“Kur je gazetar, redaktor dhe njëkohësisht edhe shpërndarës i lajmit në rrjete sociale, nuk ke as kohë për të reflektuar nëse ajo që po boton është 100% etike.”*

4.3. Mungesë njohurish dhe akses në dokumente rregullatore

Një numër i madh pjesëmarrësish nuk ishin të njohur me Kodet e Etikës së medias në Shqipëri, sidomos versionin e përditësuar të vitit 2022 dhe nuk kishin dëgjuar më parë për funksionin e Aleancës për Median Etike (AME) ose për Bordin e Ankesave. Madje, disa mendonin se vetërregullimi ishte një formë “kontrolli” nga jashtë dhe jo një sistem i bazuar në vullnet dhe përgjegjësi të brendshme.

Kjo tregon për mungesë informimi dhe trajnim, e cila mund të tejkalohet relativisht lehtë përmes ndërhyrjeve të thjeshta për shpërndarjen dhe shpjegimin e materialeve ekzistuese etike, si dhe përmes krijimit të modeleve të thjeshtuara për përdorim të brendshëm në redaksi të vogla.

4.4. Mungesa e kulturës së bashkëpunimit dhe ndarjes së përvojës

Në të dy qytetet u evidentua një mungesë e bashkëpunimit ndërmjet redaksive lokale, madje edhe kur ato përballen me të njëjtat sfida. Rivalitetet për burime financiare dhe ndikim lokal i bëjnë redaksitë të funksionojnë në mënyrë të izoluar, çka pengon ngritjen e forumeve të përbashkëta profesionale që do të mund të mbështesnin vetërregullimin horizontal dhe solidaritetin etik ndërmjet gazetarëve.

Në këtë kontekst, mungesa e organizatave profesionale, shoqatave të pavarura lokale ose aktiviteteve periodike me natyrë trajnuese ka çuar në izolim profesional dhe mungesë të dialogut rreth etikës dhe përgjegjshmërisë.

4.5. Presioni social dhe informaliteti në raportimin lokal

Në qytete si Shkodra dhe Vlora, gazetari nuk ka vetëm rol profesional, por edhe peshë sociale. Kjo e bën më të vështirë përballjen me aktorë të fuqishëm lokalë ose raportimin mbi ngjarje që përfshijnë njerëz me ndikim. Presioni që buron nga komuniteti, qoftë përmes vetëcensurës, qoftë përmes kërcënimeve të nënkuptuara, krijon një mjedis të ngushtë për zbatimin e parimeve të qarta etike, veçanërisht për gazetarët e rinj ose të paangazhuar me struktura të mëdha.

Pengesat për vetërregullimin nuk janë vetëm të natyrës teknike apo ligjore, por janë të ndërlidhura thellësisht me modelin e tregut mediatik lokal, marrëdhëniet me pushtetin dhe mungesën e mbështetjes institucionale. Kjo nënvizon rëndësinë që ndërhyrja për të promovuar vetërregullimin të mos kufizohet në ofrimin e dokumenteve apo kodifikimeve, por të shoqërohet me ndërtim kapacitetesh, krijim platformash bashkëpunimi dhe mbështetje të vazhdueshme për mediat në nivel lokal.

5. Vullneti dhe mundësitë për ndryshim

Përkundër panoramës së vështirësive të identifikuar në diskutimet mbi etikën dhe vetërregullimin, një nga gjetjet më inkurajuese të tryezave dhe fokus grupeve në Shkodër dhe Vlorë ishte shfaqja e një vullneti të qartë për ndryshim nga ana e gazetarëve lokalë. Ky vullnet nuk është domosdoshmërisht rezultat i një besimi të plotë në mekanizmat ekzistues, por i një ndjenje të fortë zhgënjimi nga status quo-ja dhe të një pritshmërie që ndryshimi mund të vijë përmes mbështetjes së jashtme, dialogut të strukturuar dhe ndërtimit të mekanizmave realistë për kushtet konkrete të punës.

Shumë pjesëmarrës shprehën se janë të gatshëm të bëjnë përpjekje për të përmirësuar standardet profesionale dhe për të aplikuar forma të vetërregullimit, për sa kohë që kjo nuk është e vendosur nga lart, por vjen si rezultat i një procesi që ata vetë e zotërojnë dhe e kuptojnë.

Disa nga formulimet më përfaqësuese që dolën në këtë drejtim përfshinin:

- *“Nëse dikush do na tregonte si ta bëjmë me mjetet që kemi, vetërregullimi do ishte i realizueshëm.”*
- *“Nuk ndërtojmë dot struktura formale, por mund të kemi disa rregulla mes nesh.”*
- *“Ne kemi nevojë për udhëzues se çfarë është etike në situata të jetës reale.”*

Këto deklarata tregojnë se ekziston një hapësirë reale për ndërhyrje transformuese, për aq kohë sa ato e respektojnë realitetin e mediave lokale, janë fleksibël në aplikim dhe të mbështetura me ndihmë teknike.

5.1. Potencial për mbështetje horizontale

Në të dy qytetet u shpreh dëshira për të krijuar forma bashkëpunimi mes mediave lokale, të cilat mund të funksionojnë si forume informale për reflektim profesional, ndarje përvojash dhe adresim të dilemave etike. Këto forma nuk kërkojnë burime të mëdha, por një koordinim minimal dhe një prani ndërmjetësuese nga organizata me përvojë si Res Publica ose Këshilli Shqiptar i Medias.

5.2. Nevoja për mjete të thjeshta dhe të aplikueshme

Shumë pjesëmarrës theksuan se ndihma më e dobishme për ta do të ishte jo një kod abstrakt, por një udhëzues praktik i shkurtër, i bazuar në situata reale me të cilat përballen në punën e përditshme. Ky udhëzues mund të mbulojë temat:

- Si të trajtohet presioni nga zyrtarët që kërkojnë të ndikojnë në përmbajtjen e lajmeve;
- Si të ruhet anonimati i burimeve në një qytet të vogël ku “të gjithë njohin njëri-tjetrin”;
- Si të reagosh kur pronari kërkon të publikosh diçka të pavërtetë;
- Si të raportosh mbi konflikte lokale pa rënë pre e njëanshmërisë;
- Si të shmangësh raportimin e lajmeve që kanë kureshtje publike, por jo interes publik.

Sa më sipër tregon nevojën për variante të thjeshtuara të etikës, që janë të kuptueshme, konkrete dhe që mund të funksionojnë edhe pa struktura formale.

5.3. Interes për lidhje me rrjete profesionale

Në të dy qytetet, pjesëmarrësit shprehën dëshirën për të pasur lidhje më të forta me rrjetet kombëtare të vetërregullimit, si AME, përmes:

- Ftesave për pjesëmarrje në trajnime apo aktivitete kombëtare;
- Mundësisë për anëtarësim të mediave lokale në Aleancë;
- Marrjes së materialeve orientuese nga AME për përdorim të brendshëm.

Ky interes nuk buron nga formaliteti, por nga nevoja për legjitimitet dhe ndjesinë e përkatësisë në një komunitet më të gjerë profesional, që mund të japë mbështetje dhe të nxisë progres.

Në përfundim, pjesëmarrësit e tryezave dhe fokus grupeve nuk ishin cinikë ndaj etikës, por të lodhur nga formalizmat dhe të etur për mjete që funksionojnë në praktikë. Ata nuk presin zgjidhje të menjëhershme, por janë të gatshëm të investojnë në një proces të kujdesshëm dhe të ndërtuar bashkë, për sa kohë që ky proces nuk i vendos ata nën rrezik dhe nuk është jashtë realitetit të tyre ekonomik dhe profesional.

6. Rekomandimet që dolën nga tryezat

Diskutimet në të dy qytetet u karakterizuan nga një qasje realiste, ku pjesëmarrësit nuk u kufizuan vetëm në analizën e problemeve, por paraqitën edhe një sërë propozimesh konkrete për përmirësimin e gjendjes dhe ndërtimin gradual të një kulture vetërregulluese të përshtatur me realitetin e mediave lokale. Këto rekomandime u mbështetën nga ekspertët e pranishëm dhe u konsideruan si një bazë e mirë për hartimin e një pakete veprimesh të mundshme në nivel lokal dhe kombëtar.

6.1. Trajnime të drejtpërdrejta në redaksi

Një kërkesë e shprehur nga disa pjesëmarrës ishte organizimi i trajnimeve të personalizuara, të zhvilluara në ambientet e vetë redaksivem mundësisht, për të shmangur mungesën e

pjesëmarrjes dhe për të krijuar ndjesinë e përfshirjes së plotë. Këto trajnime do të fokusoheshin jo vetëm në parimet teorike të etikës, por në:

- Raste konkrete të shkeljeve të etikës;
- Menaxhimin e presionit dhe konfliktit të interesit;
- Ndërtimin e një rutine të vetëreflektimit editorial.

6.2. Hartimi i udhëzuesve praktikë të shkurtër

U propozua që Këshilli Shqiptar i Medias të hartojë dhe të shpërndajë manuale të shkurtër praktikë për gazetarët, që të jenë të thjeshtë për t'u përdorur, pa gjuhë teknike, dhe të orientuar drejt situatave të zakonshme. Manualët duhet të jenë në formë digjitale dhe të shpërndahen përmes rrjeteve sociale, ose WhatsApp, ku gazetarët lokalë janë aktivë.

6.3. Nxitja e kontakteve të rregullta me AME

Në disa raste u shpreh ndjesia e izolimit nga zhvillimet kombëtare në fushën e vetërregullimit. Për këtë arsye, u rekomandua që AME të krijojë një format komunikimi me mediat lokale, përmes:

- Një buletini periodik me informacion, rekomandime dhe lajme nga Bordi i Ankesave;
- Ftesa për pjesëmarrje në ngjarje kombëtare të organizuara nga AME;
- Takime rajonale konsultative ku mediat lokale mund të ndajnë përvojat e tyre.

6.4. Platformë digjitale për dilemat etike

Si formë më e përshtatshme për kushte të kufizuara lëvizjeje apo kohe, u sugjerua krijimi i një platforme të lehtë digjitale (grup ose forum online), ku gazetarët të mund të ndajnë pyetje, dilema, raste problematike dhe të marrin përgjigje nga kolegë apo nga ekspertë të fushës. Kjo platformë mund të jetë pjesë e një forumi më të madh profesional, ose edhe një grup i mbyllur, i moderuar nga një organizatë partnere.

7. Dallime mes Shkodrës dhe Vlorës

Ndërsa shumë prej sfidave që u ngritën në tryezat dhe fokus grupet ishin të përbashkëta për të dy qytetet, si mungesa e burimeve, varësia nga reklamat lokale apo presioni politik, disa dallime të qarta dhe domethënëse u evidentuan në mënyrën si funksionojnë mediat, si e përjetojnë etikën dhe sa të hapura janë ndaj vetërregullimit.

7.1. Struktura organizative dhe përvoja e mëparshme

Në Shkodër, pjesëmarrësit përfaqësonin media me një strukturë më të qartë redaksionale, disa prej të cilave kishin ndërtuar një formë të brendshme organizimi me role të ndara (p.sh., redaktor, reporter, teknik). Në disa raste, gazetarët kishin marrë pjesë më parë në trajnime mbi etikën dhe e njihnin AME apo Kodin e Etikës, edhe pse nuk ishin anëtarë formalë të strukturave të

vetërregullimit. Një pjesë e gazetarëve kishin marrë pjesë edhe në iniciativa të mëparshme që kishin të bënin me integritetin në media, qoftë nga OSHC apo projekte ndërkombëtare.

Në Vlorë, nga ana tjetër, pavarësisht se pati përfaqësues nga modeli i mediave të përshkruara në rastin e Shkodrës, dominoi një profil mediatik më informal dhe më fragmentar. Shumë nga pjesëmarrësit nuk kishin një pozicion të rregullt. Kjo strukturë e paqëndrueshme kishte ndikim të drejtpërdrejtë në mungesën e rregullave të brendshme, pa asnjë mekanizëm etik të njohur apo të aplikuar në praktikë.

7.2. Perceptimi i rolit të medias në komunitet

Gazetarët e Shkodrës shfaqën një vetëdije më të lartë për rolin që media luan në shoqëri dhe për nevojën për të pasur standarde që dallojnë profesionistët nga prodhuesit e përmbajtjes në rrjetet sociale. Ata folën për etikën jo vetëm si mbrojtje ndaj ndërhyrjeve, por edhe si mjet për të ndërtuar besueshmëri në publik.

Në Vlorë, diskutimi u përqendrua më shumë në mbijetesën ditore të mediave dhe në presionin për të qëndruar “në lojë” përmes lajmeve të shpejta, reklamave ose bashkëpunimeve me aktorë të ndryshëm lokalë.

Në të dy qytetet etiketa “etike” shihej më shumë si luks sesa si domosdoshmëri. Megjithatë, u vu re një interes i sinqertë nga gazetarët e rinj për të kuptuar dhe integruar parime bazë të etikës në punën e përditshme, për sa kohë që ato ishin të qarta dhe të përshtatshme me realitetin.

7.3. Gatishmëria për bashkëpunim

Në të dy qytetet u konstatua gatishmëria për të ndërtuar forma të bashkëpunimit horizontal. Në Shkodër, disa pjesëmarrës kishin tashmë kontakte të mëparshme me njëri-tjetrin, dhe shfaqën interes për të marrë pjesë në grupe informal për të trajtuar çështje të përbashkëta.

Në Vlorë, nga pjesëmarrësit u konstatua rivalitet më i thellë midis disa mediave, duke e bërë të vështirë propozimin për platforma të përbashkëta. Megjithatë, pjesëmarrësit dhanë idenë se një ndërmjetësues i jashtëm, si Res Publica apo KSHM, do të ishin e mirëpritur për të ndihmuar në ndërtimin e një mjedisi bashkëpunues.

7.4. Kërkesat prioritare

Në Shkodër, kërkesat prioritare për ndihmë u përqendruan në:

- Formalizimin e kodeve të brendshëm;
- Lidhjen me strukturat e vetërregullimit kombëtar;
- Shkëmbimin e praktikave me media të tjera rajonale.

Ndërsa në Vlorë, u theksua nevoja për:

- Trajnime të thelluara mbi etikën;
- Mbështetje për redaksitë;
- Krijimin e një identiteti profesional më të qartë për mediat vendore.

8. Konkluzione

Tryezat e rrumbullakëta dhe fokus grupet e zhvilluara në Shkodër dhe Vlorë konfirmuan qartë se mungesa e mekanizmave të vetërregullimit në mediat lokale nuk është rezultat i mungesës së vullnetit, por i një kombinimi kompleks faktorësh, si presionet ekonomike, mungesa e strukturave redaksionale, mosinformimi mbi standardet ekzistuese dhe një kulturë profesionale që ende nuk është ndërtuar mbi parimin e përgjegjësisë mediatike.

Nga njëra anë, gazetarët lokalë përballen me një realitet ku etika profesionale sfidohet përditë nga nevoja për mbijetesë, nga mungesa e sigurisë në punë dhe nga ndikimet e drejtpërdrejta të pushtetit lokal apo interesave tregtare. Nga ana tjetër, pikërisht për shkak të këtij realiteti të vështirë, krijimi i një kuadri etik të brendshëm dhe i një rrjeti solidariteti profesional bëhet më shumë se kurrë një nevojë urgjente dhe jetike.

Diskutimet treguan se ekziston një gatishmëri reale për ndryshim, për sa kohë që ndërhyrjet janë të përshtatura me kapacitetet dhe realitetin lokal. Gazetarët nuk kërkojnë modele të huaja ose struktura të imponuara, por mjete konkrete që funksionojnë për ta, kode të thjeshta të brendshme, trajnime që flasin gjuhën e përditshme të redaksisë lokale, dhe hapësira bashkëpunimi që ofrojnë mbështetje dhe jo kontroll.

Ndërhyrja e zhvilluar përmes këtij projekti ka treguar se dialogu profesional i strukturuar, i kombinuar me një qasje metodologjike gjithëpërfshirëse dhe me ndihmë të matur teknike, është mjeti më i mirë për të ndërtuar themelin për ndryshim afatgjatë. Ajo ka ofruar prova se vetërregullimi nuk është vetëm i mundur në media lokale, por mund të jetë edhe më i qëndrueshëm, nëse bazohet në ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen e vetë aktorëve lokalë.

Në përmbyllje, mund të konkludohet se:

- Ka një hendek real mes standardeve etike të pranuar në nivel kombëtar dhe praktikave të përditshme në media lokale;
- Ky hendek mund të tejkalohet nëse ndërhyrjet janë graduale, praktike dhe të ndërtuara bashkë me komunitetin gazetaresk lokal;
- Procesi i nisur përmes këtij projekti duhet të vazhdojë dhe të zgjerohet, me mbështetje të mëtejshme për ndërtimin e rrjeteve rajonale, forcimin e bashkëpunimit me AME dhe prodhimin e instrumenteve trajnues të përshtatur sipas nevojave të çdo zone.

Në përfundim, kjo analizë është një pikënisje për ndërtimin e një modeli vetërregullimi nga poshtë-lart, që i jep zë gazetarëve lokalë, fuqizon redaksitë e vogla dhe kontribuon në rritjen e cilësisë së informacionit në shërbim të publikut.